

Eppc kërkon një **Oficer/e të mbledhjes së borxhit** për klientin e saj, një ndër institucionet financiare kredidhënëse më të njohura në treg.

Një vështrim i përgjithshëm

Në linja të përgjithshme detyra do të konsistojë në kontaktimin e debitorëve në funksion të mbledhjes së detyrimeve të tyre të papaguara në sa më pak kohë të jetë e mundur.

Përgjegjësitë Kryesore:

- Ndërton, mirëmban dhe zhvillon një data bazë kërkimore për të identifikuar borxhet e papaguara ;
- Inicion, zhvillon dhe menaxhon marrëdhëniet me klientët nëpërmjet telefonit;
- Negocion afatet e pagesave ose planifikon realizimin e tyre;
- Trajtoni pyetje ose ankesa duke hetuar dhe zgjidhur problemet;
- Zhvillon plane specifike të bazuara mbi marrëdhënien e besimit me debitorët kur është e mundur për të shmangur krijimin e detyrimeve në të ardhmen;
- Analizon kapacitetet ripaguese të klientit duke realizuar një plan pagese sipas udhëzimeve dhe politikave të kompanisë;
- Ofron këshillim financiar dhe shërbim klienti cilësor.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare;
- **Eksperiencë në mbledhjen / rikuperimin e borxheve (minimumi 3 vjetë);**
- Të ketë iniciativë dhe të orientohet drejt rezultateve;
- Të jetë konfident, fleksibël, elokuent dhe entuziast;
- Të jetë i aftë të punojë në mënyrë të pavarur dhe brenda afateve;
- Të zotërojë mirë MS Office.

Të dhënat:

Pozicioni:	Oficer/e i mbledhjes së borxhit;
Vendndodhja:	Tiranë;
Orari:	40 orë;
Pagesa:	Shumë e mirë (<i>fikse + bonuse</i>);
Kontrata:	Sipas Kodit të Punës;
Aplikimet mbyllen:	25.10.2017

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail^{it}:

recruitments@eppc.al

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen.
Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.